



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 26.11.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, , Fatmir Xhelili, Xhelal Sveçla, Daut Haradinaj, Bahrim Shabani, Fadil Beka, Ismet Beqiri, anëtarë.

Munguan: Ramiz Kelmendi dhe, Zoran Mojsiloviç, Aida Dërguti,

Nga stafi mbështetës i komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Haxhi Shala , kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes,
3. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
4. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës;
5. Të ndryshme.

Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes,

Kryetari, theksoi se grupi punues për shqyrtimin e këtij projektligji, por edhe projektligjeve të tjera që janë në këtë rend ditës, kanë kryer punë e tyre, ku përgjatë kësaj kohe janë realizuar takime të grupit punues bashkë me përfaqësuesit e Ministrisë së FSK-së, gjithashtu janë organizuara edhe dy dëgjime publike. Ndërsa sa i përket amendamenteve të propozuar për këtë projektligj, theksoi se janë përgatitur dhe u janë shpërndarë anëtarëve të Komisionit.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOAMDNI

Raporti me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes miratohet pa vërejte dhe procedohet tek komisionet e përhershme të kuvendit për opinion.

3. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kryetari, theksoi edhe për këtë projektligj janë mbajtur takime dhe dëgjime publike, prandaj propozoi që të hidhet në votim ky raport, me përjashtim të amendamentit dymbëdhjetë, për të cilin është rënë dakord që të hiqet nga takimi i grupit punues.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOAMDNI

Raporti me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës miratohet pa vërejtje dhe procedohet tek komisionet e përhershme të kuvendit për opinion.

4. Shqyrtimi i raportit me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kryetari, edhe për këtë projektligj propozoi që të hidhet në votim raporti me propozim amendamente, në rast se ka vërejtje mu të theksohen tani.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

REKOAMDNIM

Raporti me propozim-amendamente për Projektligjin Nr.06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës pa vërejtje dhe procedohet tek komisionet e përhershme të kuvendit për opinion.

5. Të ndryshme.

Nuk pati çështje për tu diskutuar.

Kryetari, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi takimin e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:10.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Haxhi Shala